

RAPORT MONITORIMI

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

JANAR – DHJETOR 2021


Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP) është tërësia e institucioneve administrative dhe ofruese të shërbimeve arsimore parauniversitare, pjesë integrale e sistemit të ministrisë përgjegjëse për arsimin, që kontribuon në realizimin e qëllimit të përgjithshëm për shërbim arsimor cilësor.

DPAP-ja ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë e organizuar në:

- **Nivel qëndror**, nëpërmjet drejtorisë qendrore - DPAP.
- **Nivel rajonal**, nëpërmjet drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar - DRAP.
- Njësitë e ofrimit direkt të shërbimeve, të cilat përfshijnë **zyrat vendore të arsimit parauniversitar ZVAP**.
- **Institucionet arsimore** të sistemit parauniversitar publik, shkollat.

Misioni i DPAP-së është ofrimi dhe sigurimi i shërbimit arsimor cilësor në të gjitha institucionet arsimore të sistemit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me politikën, strategjitë kombëtare dhe kurrikulën e arsimit parauniversitar, me qëllim zhvillimin dhe edukimin e plotë e të gjithanshëm të nxënësit, në mënyrë që të përballojë sfidat e së ardhmes.

Tabela më poshtë paraqet strukturën organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar;



Numri i punonjësve buxhetorë për DRAP dhe ZVAP.

NUMRI I PUNONJESVE-			NUMRI I PUNONJESVE-			NUMRI I PUNONJESVE-			NUMRI I PUNONJESVE-		
NR. DRAP/ZVAP		PLAN	NR. DRAP/ZVAP		PLAN	NR. DRAP/ZVAP		PLAN	NR. DRAP/ZVAP		E-PLAN
I.I	Drejtoria Rajonale Arsimore Durrës	15	II.	Drejtoria Rajonale Arsimore Fier	15	III.	Drejtoria Rajonale Arsimore Korçë	15	IV.	Drejtoria Rajonale Arsimore Lezhe	15
1	Zyra Vendore Arsimore Bulqizë	6	1	Zyra Vendore Arsimore Patos	6	1	Zyra Vendore Arsimore Ura Vajgujori	6	1	Zyra Vendore Arsimore Has	6
2	Zyra Vendore Arsimore Mat	6	2	Zyra Vendore Arsimore Roskovec	6	2	Zyra Vendore Arsimore Kuçovë	6	2	Zyra Vendore Arsimore Tropojë	6
3	Zyra Vendore Arsimore Klos	6	3	Zyra Vendore Arsimore Divjakë	6	3	Zyra Vendore Arsimore Cërrik	6	3	Zyra Vendore Arsimore Mirditë	6
4	Zyra Vendore Arsimore Shijak	6	4	Zyra Vendore Arsimore Mallakastër	6	4	Zyra Vendore Arsimore Belsh	6	4	Zyra Vendore Arsimore Malësi e Madhe	6
5	Zyra Vendore Arsimore Kavajë	8	5	Zyra Vendore Arsimore Selenicë	6	5	Zyra Vendore Arsimore Peqin	6	5	Zyra Vendore Arsimore Vau Dejës	6
6	Zyra Vendore Arsimore Vorë	6	6	Zyra Vendore Arsimore Fierë-Dropull	6	6	Zyra Vendore Arsimore Gramsh	6	6	Zyra Vendore Arsimore Puke -Fushë	6
7	Zyra Vendore Arsimore Rrogozhinë	6	7	Zyra Vendore Arsimore Gjakovë-Li	6	7	Zyra Vendore Arsimore Librazhd	9	7	Zyra Vendore Arsimore Kukës	10
8	Zyra Vendore Arsimore Dibër	9	8	Zyra Vendore Arsimore Tepelenë- M	6	8	Zyra Vendore Arsimore Përrenjas	6	8	Zyra Vendore Arsimore Lezhë	10
9	Zyra Vendore Arsimore Krujë	8	9	Zyra Vendore Arsimore Përmet-Këlç	6	9	Zyra Vendore Arsimore Maliq	8	9	Zyra Vendore Arsimore Kurbin	9
10	Zyra Vendore Arsimore Kamëz	11	10	Zyra Vendore Arsimore Sarandë-Koni	9	10	Zyra Vendore Arsimore Kolonjë	6	10	Zyra Vendore Arsimore Shkodër	15
11	Zyra Vendore Arsimore Durrës	15	11	Zyra Vendore Arsimore Lushnjë	11	11	Zyra Vendore Arsimore Devoll	6	TOTALI		95
12	Zyra Vendore Arsimore Tiranë	35	12	Zyra Vendore Arsimore Vlore-Himarë	11	12	Zyra Vendore Arsimore Skrapar	6			
TOTALI		137	13	Zyra Vendore Arsimore Fier	15	13	Zyra Vendore Arsimore Poliçan	6			
			TOTALI		115	14	Zyra Vendore Arsimore Berat	10			
						15	Zyra Vendore Arsimore Korçë-Pustec	9			
						16	Zyra Vendore Arsimore Pogradec	9			
						17	Zyra Vendore Arsimore Elbasan	15			
						TOTALI		141			

I. ADMINISTRIMI DHE MENAXHIMI I FONDEVE BUXHETORE

Monitorimi i Buxhetit Financiar të periudhës Janar-Dhjetor 2021 për institucionin, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, përfaqëson vlerësimin e performancës në përdorimin e fondeve buxhetore nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuara, duke i krahasuar edhe me treguesit e vitit të mëparshëm.

Nëpërmjet këtij raporti monitorimi evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të DPAP-së, të detajuar në nivel kategorie shpenzimi buxhetor kundrejt treguesve të planifikuar, duke mundësuar kështu sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar ka filluar funksionimin e saj më 20.05.2019, me VKM nr. 99, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, Urdhrit nr.68, datë 05.04.2019, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar”, ndryshuar me urdhërin nr.149, datë 09.11.2020.

Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar menaxhon fondet buxhetore të pagave, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative vetëm në një program buxhetor dhe për numrin e punonjësve sipas tabelës më poshtë:


Punonjës të planifikuar për vitin 2021	21
Punonjës Fakt 2021	19
Punonjës me kontratë	1

1. Planifikim Menaxhim.

Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2021, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar është mbështetur në dispozitat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit të MFE nr. 09, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”, të ligjit nr.137/2020 “ Për Buxhetin e vitit 2021”, Udhëzimit plotësues nr. 04, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2021”.

Për periudhën Janar- Dhjetor 2021 Drejtorie Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar ka realizuar fondet buxhetore sipas planit të rishikuar buxhetor për çdo Grup, Titull, Artikull sipas tabelës:

ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"								në 000/leke
Periudha Janar- Dhjetor 2021								
Emri i Grupit	DPAP							Kodi i Grupit
Programi	Administrim Menaxhim							Kodi i Programit
Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2020	(2) PBA Plan Viti 2021	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhës/progresiv	(6) Fakti i Periudhës/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga	18,519	20,874	17,640	18,040	18,040	17,521	-519
601	Sigurime Shoqërore	3,053	3,218	2,946	3,046	3,046	2,903	-143
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	1,983	4,750	2,700	2,464	2,464	2,459	-5
603	Subvencione	0	0	0	0	0	0	0
604	Transferta Korente të Brendshme	0	0	0	0	0	0	0
605	Transferta Korente të Huaja	0	0	0	0	0	0	0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	0	150	0	147	147	147	0
Nen -Totali	Shpenzime Korrente	23,555	28,992	23,286	23,697	23,697	23,030	-667
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	165	5,000	0	0	0	0	0
232	Transferta Kapitale	0	0	0	0	0	0	0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	165	5,000	0	0	0	0	0
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	0	0	0	0	0	0	0
232	Transferta Kapitale	0	0	0	0	0	0	0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0	0	0	0
Totali	Shpenzime Kapitale	165	5,000	0	0	0	0	0
Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti								
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		23,720	33,992	23,286	23,697	23,697	23,030	-667



2. FONDET E MIRATUARA:

A- Shpenzime Personeli

Fondet e miratuara për shpenzime personeli për vitin 2021 përfshijnë fondet e miratuara për pagat dhe sigurimet shoqërore. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar mbulon shpenzimet e personelit vetëm për punonjësit e DPAP-së.

➤ Pagat e punonjësve. Llogaria 600

Fondi i miratuar nga buxheti i shtetit për vitin 2021 në zërin “paga” (600) është parashikuar dhe çelur në shumën 17,640,000 lekë, ky fond është rishikuar për vitin 2021 në shumën 18,040,000 lekë. Fondi i planifikuar për periudhën Janar–Dhjetor 2021 është në shumën 18,040,000 lekë dhe realizimi i fondit të pagave për këtë periudhë është 17,521,130 lekë ose 97% e planit të periudhës Janar- Dhjetor 2021. Diferenca në 518,870 lekë, ose 3% e fondit total të pagave vjen si rezultat i mosplotësimit të organikës së DPAP-së, pra i mungesës së punonjësve, krahasuar me planin 2021.

➤ Sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Llogaria 601

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2021 në zërin; Sigurime shoqërore dhe shëndetësore (601), është çelur në shumën 2,946,000 lekë dhe është rishikuar për vitin 2021 duke arritur në shumën 3,045,880 lekë. Fondi i planifikuar për periudhën Janar–Dhjetor 2021 është në shumën 3,045,880 lekë, realizuar 2,903,309 lekë ose 95% të planit të periudhës Janar-Dhjetor 2021. Janë likujduar të gjitha detyrimet për periudhën.

B- Shpenzime Operative

Fondet e miratuara për shpenzime operative për vitin 2021 përfshijnë fondet e miratuara për blerjen e mallrave dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për funksionimin e institucionit, pa përfshirë shpenzimet për DRAP dhe ZVAP.

➤ Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera. Llogaria 602

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2021 në zërin mallra e shërbime të tjera (llogaria 602) është çelur në shumën 2,700,000 lekë dhe pas rishikimit të planit vjetor duke përfshirë shtesat dhe pakësimet, plani për shpenzime operative për vitin 2021 është 2,464,000 lekë. Janë realizuar 2,458,481 lekë për periudhën Janar-Dhjetor 2021 ose 99,7 % të planit të periudhës vjetore.

Shpenzimet për këtë periudhë kryesisht janë fokusuar për mbulimin e shpenzimeve operative si drita, ujë, telefon, shërbim postar, karburant dhe udhëtim e dieta për punonjësit që janë dërguar me shërbim jashtë qendrës së punës.

Vihet re një plan shumë i vogël në lekë për shpenzime operative, pasi Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar ka në varësi të saj 52 Zyra Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe 4 Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, por për shkak të situatës së krijuar ga pandemia COVID-19, nuk janë realizuar të gjitha inspektimet apo takimet në institucionet e varësisë. Ato janë kryer kryesisht online pa ndikuar në nivelin e shpenzimeve për karburant, apo udhëtim e dieta. Gjithashtu dhe prokurimet nuk janë kryer të gjitha sipas nevojave të institucionit për shkak të situatës së krijuar dhe të mungesës në fonde.

C- Transferta për buxhetet familjare dhe individët. Llogaria 606

Për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2021 në fillim të vitit nuk kemi pasur planifikim fondesh për transferta për buxhetet familjare apo individë dhe gjatë periudhës pas rishikimit të fondeve dhe

kërkesës nga DPAP për fonde, për shpërblimin e dy punonjësve që kanë dalë në pension ka pasur rialokim fondesh në këtë llogari në shumën 147,000 lekë dhe janë realizuar 147,000 lekë për periudhën Janar-Dhjetor 2021. Pra kemi realizim 100% të fondit për buxhete familjare dhe individë, pasi planifikimi dhe përdorimi për vitin 2021 ishte për dy punonjës nga një pagë shpërblim për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për arsye të daljes në pension pleqërie.

D- Shpenzime për investime kapitale. Llogaria 231.


Plani i buxhetit për vitin 2021 në investime kapitale është zero lekë. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar mbulon vetëm shpenzimet për institucionin dhe nuk ka pasur fonde në këto shpenzime. Në bazë të planifikimit të buxhetit dhe të rregullores për funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, janë Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar që menaxhojnë fondet për shpenzime kapitale për institucionet e tyre dhe të varësisë.

Në programin 09120 dhe 9230 për vitin 2021 këto fonde i kanë kaluar Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar, pasi është parë mundësia për një shpërndarje sa më të drejtë dhe efektive të mallrave dhe shërbimeve sipas DRAP-ve.


Paraqitja përmbledhëse e shpenzimeve të periudhës Janar - Dhjetor 2021 në DPAP, krahasuar me realizimin e vitit të kaluar dhe planin buxhetor për vitin 2021 paraqiten në tabelat dhe grafikët e mëposhtëm:

ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treqesve te performances/produkteve te programit"


Emri i Grupit	DPAP	Kodi i Grupit	1011265																
Programi	Administrim Manaxhim	Kodi i Programit	1110																
Periodha Janar- Dhjetor 2021																			
	ne 000/leke		I			II			III			IV			Luhatjet në Koston për Njësi				
Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Nësia masese	Sasia Faktike (sipas vitit paraardhes)	Shpenzimet (sipas vitit paraardhes)	Kosto per Njësi (sipas vitit paraardhes)	Sasia (sipas planit te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te vitit korent)	Kosto per Njësi (sipas planit te vitit korent)	Sasia (sipas planit te rishikuar te vitit koren ^a)	Shpenzimet (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Kosto per Njësi (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Sasia Faktike (ne fund te vitit koren ^a)	Shpenzim et Faktike (ne fund te vitit korent)	Kosto per Njësi Faktike (ne fund te vitit koren ^a)	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III	Komentet	
91101AE	Shpenzime paga	21	21	18,519	882	21	17,640	840	21	18,040	859	21	17,521	834	-48	-6	-25		
91101AE	Sigurime	21	21	3,053	145	21	2,946	140	21	3,046	145	21	2,903	138	-7	-2	-7		
91101AE	Transferta	21	21	0	0	21	0	0	21	147	7	21	77	4	4	4	-3		
91101AE	Karburant	21	21	336	16	21	500	24	21	450	21	21	448	21	5	-2	0		
91101AE	Shpenzime udhetimi (diela, bileta,hotel)	21	21	306	15	21	700	33	21	478	23	21	478	23	8	-11	0		
91101AA	Shpenzime udhetimi (diela, bileta,hotel)	21	21	312	15	21	200	10	21	499	24	21	499	24	9	14	0		
91101AE	Telefon, dhita, ujë postë , internet etj.	21	21	525	25	21	0	0	21	0	0	21	0	0	-25	0	0		
91101AA	Telefon, dhita, ujë postë , internet etj.	21	21	111	5	21	830	40	21	613	29	21	613	29	24	-10	0		
91101AA	Sherbime printiri fletepalosje	21	21	0		21	50	2	21	0	0	21	0	0	0	-2	0		
91101AE	Shpenzime të tjera gjatë vitit	21	21	0	0	21	0	0	21	0	0	21	0	0	0	0	0		
91101AA	Kancelari	21	21	99	5	21	100	5	21	100	5	21	100	5	0	0	0		
91101AE	Taksa Bashkia, Auto,siguracion	21	21	15	1	21	0	0	21	0	0	21	0	0	-1	0	0		
91101AA	Taksa Bashkia, Auto,siguracion	21	21	0	0	21	70	3	21	67	3	21	67	3	3	0	0		
91101AA	Tona	21	21	53	3	21	100	5	21	100	5	21	99	5	2	0	0		
91101AA	Mirëmbajtje pajise elektronike	21	21	97	5	21	50	2	21	0	0	21	0	0	-5	-2	0		
91101AA	Materiale pastrimi	21	21	99	5	21	0	0	21	0	0	21	0	0	-5	0	0		
91101AE	Materiale pastrimi	21	21	0	0	21	70	3	21	70	3	21	68	3	3	0	0		
91101AA	Dezinfekim zyra	21	21	30	0	21	30	1	21	0	0	21	0	0	0	-1	0		
91101AA	Program kompjuterik për funksionimin e prooramit të transparencës	21	21	0		21	0	0	21	87	4	21	86	4	4	4	0		



- Struktura e fondeve të planifikuara sipas grup artikujve për vitin 2021 në DPAP



- Struktura e fondeve të planifikuara sipas grup artikujve për vitin 2021 në DPAP



3. Mbi raportimin e detyrimeve të prapambetura të akumuluar dhe krijuara rishtazi për vitin 2021.

Në zbatim të ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, vendimit nr.50, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”, si dhe të udhëzimit nr. 5, datë 27.02.2014, të Ministrit të Financave “Për shlyerjen e detyrimeve të

prapambetura”, Shtojca 3, detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi dhe akumuluar për vitin 2021 janë **zero** lekë.

Për sa më sipër në periudhën Janar-Dhjetor 2021 në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar nuk është krijuar asnjë detyrim dhe nuk kemi detyrime të prapambetura të mbartura nga vitet e kaluara.

4. Faktorët që kanë ndikuar në realizimin e buxhetit për vitin 2021:

1. Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 09, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”.
2. Ligji nr.137/2021 “ Për Buxhetin e vitit 2021”.
3. Udhëzimi plotësues nr. 04, datë 25.01.2021, “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2021.
4. Udhëzimi nr. 14, datë 24.03.2020, i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat e menaxhimit dhe monitorimit të zbatimit të buxhetit në gjendjen e fatkeqësisë natyrore”.
4. Urdhëri nr. 135, datë 09.03.2020, i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ”Për mbylljen e institucioneve Arsimore për parandalimine përhapjes së Covid-19”.
5. Mosrealizimi i shpenzimeve korente artikulli 602, është kryesisht në zërin udhëtim e dieta për shkak të mosrealizimit të inspektimeve, monitorimeve, takimeve nga situata e krijuar nga COVID-19.

II.TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Viti shkollor 2020-2021

Kopshtet		Totali kopshte	Shkolla publike (drejtori me vete)		Totali shkolla publike	Shkolla private		Totali shkolla private
Publike	Private		9-vjeçare +Mesme te Bashkuara	Gjimnaze + mesme të orientuara		9-vjeçare	Mesme	
1907	249	2156	1057	346	1403	115	105	220

Kopshte gjithsej		Totali kopshte	Shkolla Publike (drejtori më vete)		Totali shkolla publike	Shkolla Private		Totali shkolla private
Publik	Privat		9-vjeçare + Mesme Bashkuara	Gjimnaze + mesme të orientuara te Veçanta		9-vjeçare	Mesme	
1847	243	2090	1051	347	1398	115	105	220

Viti shkollor 2021-2022

II.1 Të dhëna mbi numrin e institucioneve arsimore për vitin shkollor 2020-2021 dhe 2021-2022

Numri i nxënësve për vitin shkollor 2021-2022

Në Kopshte gjithsej		Total fëmijë në kopshte	Numri i nxënësve në Shkolla Publike (drejtori më vete)		Totali në shkolla publike	Numri i nxënësve në Shkolla Private		Totali në shkolla private
Publik	Privat		9-vjeçare	Gjimnaze + mesme të orientuara te Veçanta		9-vjeçare	Mesme	
62104	10280	72384	251207	73042	324249	26931	12146	39177

II.2 Të dhëna për numrin e punonjësve mësimorë, për vitin shkollor 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022



Numri i punonjësve mësimor në AMU

INSTITUCIONI	Numri i miratuar i punonjësve për vitin shkollor 2019-2020	Numri i miratuar i punonjësve për vitin shkollor 2020-2021
--------------	--	--

DRAP FIER	4,839	4,692
DRAP KORÇË	6,164	6,113
DRAP DURRËS	8,468	8,754
DRAP LEZHË	4,184	4,096
TOTALI	23,655	23,655

Numri i punonjësve mësimor në AML

INSTITUCIONI	Numri i miratuar i punonjesve per vitin shkollor 2019-2020	Numri i miratuar i punonjesve per vitin shkollor 2020-2021
DRAP FIER	1,339	1,281
DRAP KORÇË	1,624	1,605
DRAP DURRËS	2,396	2,491
DRAP LEZHË	1,126	1,108
TOTALI	6,485	6,485



Për vitin 2021-2022 numri i punonjësve për 4 DRAP nuk ka ndryshim nga viti 2020-2021

II.3 Të dhëna për mësimin e zhvilluar për periudhën janar-qershor 2021

- ❖ Në institucionet e arsimit parauniversitar procesi mësimor ka vijuar normalisht, sipas skenarëve të miratuar dhe turneve përkatëse. Theksojme se mësimi në shkollat e mesme në zonën me risk të lartë, zonë e kuqe, të përcaktuar nga Komiteti i Eksperteve, zhvillohej sipas skenarit 3 (online). Shkollat e mesme në këtë zonë, procesin mësimor e realizojnë nëpërmjet platformave të ndryshme, google classroom / zoom dhe whatsapp. Informacioni për skenarët është i përjavshëm sipas formatit më poshtë:

SKENARET QE DO TE NDIQEN NGA SHKOLLAT NGA 29 MARS - 2 PRILL 2021													
NR.	DRAP	VARIANTI A								VARIANTI B		SKENARI 3	
		1		2.1		2.2		2.3		SHKOLLA	NXËNËS	SHKOLLA ²	NXËNËS
		SHKOLLA ¹	NXËNËS	SHKOLLA ¹	NXËNËS	SHKOLLA ¹	NXËNËS	SHKOLLA ¹	NXËNËS				
1	DURRES	386	45962	67	18312	58	28323	78	54219			126	36038
2	FIER	404	32785	12	2891	40	12967	10	7544	1	322	72	13507
3	KORÇË	628	47132	34	9307	47	16838	2	342			22	5301
4	LEZHË	389	34109	7	2261	33	11861	13	4957			14	2638
	TOTALI	1807	159988	120	32771	178	69989	103	67062	1	322	234	57484
¹ Tek shkollat janë përfshirë edhe shkollat vartese si dhe disa profesionale që kanë raportuar													
² Me Skenarin 3 janë shkollat e mesme të ZONËS SE KUQË me risk të lartë													

- Numri i mësuesve me kontratë për përballimin e situatës me COVID-19:

Në bazë të VKM nr.769, datë 30.09.2020 “Për përcaktimin e numrit maksimal të punonjësve me kontratë të përkohshme për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë”, numri i punonjësve arsimorë me kontratë të përkohshme ose me kontratë me kohë të pjesshme për vitin **shkollor 2020-2021**, është jo më shumë 1 000 (një mijë) punonjës. Këta punonjës janë aktivizuar për plotësimin e nevojave në institucionet arsimore për zëvendësimin e mësuesve me COVID-19.

NR	DRAP	ORGANIKA SHITESË	Arsimi Baze (9120)	Arsimi Mesem (9230)
1	DRAP DURRËS	415	291	124
2	DRAP FIER	188	132	56
3	DRAP KORÇË	247	173	74
4	DRAP LEZHË	150	104	46
GJITHSEJ PUNONJËS TË RISHPËRNDARË		1000	700	300

II.4 Të dhëna për punësimet për periudhën Janar-Dhjetor 2021.

Punësimet për periudhën Janar-Dhjetor 2021 në institucionet arsimore, nga portali “Mësues për Shqipërinë” dhe jashtë portalit kur ka qenë e nevojshme, në nivel DRAP-i janë:

NR.	DRAP	Punësime vende vakante definitive nga portali	Punësime vende vakante provizore nga portali	Punësime me kandidatë jashtë portalit	Gjithsej punësime
1	DRAP Durrës	496	1005	764	2265
2	DRAP Fier	120	749	250	1119
3	DRAP Korçë	168	781	222	1171
4	DRAP Lezhë	126	374	602	1102
TOTALI JANAR - DHJETOR 2021		910	2909	1838	5657

III. VEPRIMTARI MONITORUESE DHE VLERËSUESE

Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP) ka zhvilluar veprimtarinë e saj, duke zbatuar planin vjetor mbështetur në prioritetet e MASR.

DPAP ka zhvilluar funksionet e saj me veprimtari, të tilla si:

- Vlerësimi i cilësisë së shërbimit të institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar;
- Vlerësimi i njësive arsimore vendore në arsimin parauniversitar;
- Vlerësimi i drejtorive rajonale në arsimin parauniversitar;
- Kontrolli i pajtueshmërisë të veprimtarive të institucioneve arsimore dhe të njësive arsimore vendore me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;
-
- Këshillimi i drejtuesve dhe punonjësve të institucioneve arsimore e të njësive arsimore vendore;
- Monitorimi i procesit të shpërndarjes së teksteve shkollore;
- Monitorimi i zbatimit të Rregullores për funksionimin e IAP;
- Vlerësim i IA, për zbatimin e masave anti COVID-19;

- Monitorimi i shkollës për cilësinë e realizimit të veprimtarisë mësimore-edukative, në përputhje me “skenarin 2”, për përmirësimin e shërbimit arsimor parauniversitar,
- Monitorimi, vlerësimi, nxjerrja e përfundimeve dhe këshillimi për zhvillimin e arsimit parauniversitar;
- Informimi i Ministrit, njësive arsimore vendore dhe institucioneve për gjetjet e inspektimeve arsimore;
- Inspektime bazuar në ankesa;
- Trajtim ankesash,...etj.

Për vitin 2021, nuk janë realizuar të gjitha veprimtaritë e planifikuara për shkak të situatës COVID-19, por janë realizuar edhe inspektime/monitorime pa planifikim si më poshtë vijon:

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar janë kryer 164 monitorime/inspektime gjithsej gjatë viti 2021.

DPAP ka trajtuar dhe ka kthyer përgjigje të ankesave që kanë ardhur në rrugë elektronike dhe me postë, rreth 150 ankesa për periudhën janar-dhjetor 2021.

IV. KURRIKULA DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

IV.1 Vlerësimi dhe monitorimi i shërbimit psiko-social gjatë vitit shkollor 2020-2021 dhe 2021-2022 konsistoi në:

- ✓ Në mbështetje të urdhrit të Ministrit të MASR nr.313, datë 20.10.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social”, në bazë të rakordimit dhe kërkesave të ZVAP-ve është bërë përllogaritja e ndryshimit të numrit të punonjësve të shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar.
 - a) një psikolog/punonjës social për 500-700 nxënës.
 - b) dy psikologë/punonjës social për çdo shkollë me mbi 700 nxënës.
 - c) një psikolog/punonjës social për çdo shkollë që ka të paktën 10 nxënës me aftësi të kufizuar, të përcaktuar me raport të komisionit Mjeko-Ligjor.
 - d) një psikolog për çdo shkollë të arsimit special.
 - e) një psikolog/punonjës social do të mbulojë disa shkolla në rastet kur shkollat janë me numër më të vogël se 500 nxënës.

Në vitin shkollor 2019-2020 kishim 342 punonjës të shërbimit psiko-social.

Në vitin shkollor 2020-2021e në vijim kemi gjithsej 592 punonjës të shërbimit psiko-social.

IV. 2 Matura shtetërore 2021

Në zbatim të Urdhrit Nr. 364, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë”, janë organizuar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë provimet e Maturës Shtetërore 2021, në datat:

1. **03.06.2021** – provimi i Gjuhës së Huaj (D3).
2. **07.06.2021** – provimi i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë (D1).
3. **11.06.2021** – provimi i Matematikës (D2).
4. **15.06.2021** – provimi i lëndës me zgjedhje.

Në Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar në varësi, është monitoruar nga DPAP dhe DRAP zbatimi i Rregullores së Maturës Shtetërore 2021, për planifikimin, organizimin dhe realizimin e gjithë procesit që nga përcaktimi i qendrave të provimit, trajnimin e administratorëve, monitorimin ditën e provimit si dhe analizën e plotë të ecurisë së tyre.

Nga të dhënat e mbledhura për çdo provim, konstatohet se në tre provimet e para pjesëmarrja e nxënësve ka qenë 96 % edhe në provimin me zgjedhje 97 %.

Janë organizuar në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë provimet e Maturës Shtetërore 2021, Sesion II, në datat:

1. **24.08.2021** – provimi i Gjuhës së Huaj (D3).
2. **27.08.2021** – provimi i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë (D1).
3. **31.08.2021** – provimi i Matematikës (D2).
4. **03.09.2021** – provimi i lëndës me zgjedhje.

IV.3 Për identifikimin e nevojave të nxënësve për përmirësim e njohurive të marra gjatë mësimit online.

Në vijim të shkresës nr. 2483 prot., datë 30.04.2021, “Për zbatim”, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, e cila ka hartuar planin e veprimit “Për zhvillimin e arritjeve të nxënësve, me qëllim identifikimin e nevojave për përmirësimin e tyre, si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19”, në javën e fundit të muajit maj u zhvilluan teste për klasat I-IV, VI-VIII- dhe X-XI. Këto teste ishin vetëm diagnostikuese dhe nuk janë vlerësuar me notë.

DPAP-ja ngriti grupe pune për të përcaktuar të gjitha rezultatet e të nxënësve që janë përdorur nga programet orientuese për hartimin e testeve për secilën lëndë dhe klasë.


Për të gjitha testimet pas vlerësimit të tyre dhe pas përpunimit të të dhënave, janë evidentuar konceptet që kanë nevojë për përsëritje, përforsim, konsultime. Këto të dhëna ju paraqitën të detajuara ASCAP dhe MASR mbi të cilat u përgatitën udhëzuesit për përmirësimin e arritjeve të nxënësve në arsimin fillor, si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19.

IV.4 Të dhëna për procesit të praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit në nivel DRAP/ZVAP.

Mbështetur në VKM nr 686, datë 23.10.2019 “Për kryerjen e praktikës profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit, të ndryshuar, referuar shkresës së MASR me nr.4689 prot., datë 01.09.2021, “Për zhvillimin e praktikës profesionale në profesionin e rregulluar të mësuesit për vitin mësimor 2021-2022”, në institucionet arsimore janë planifikuar 2300 praktikantë për të zhvilluar praktikën profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit për vitin shkollor 2021-2022.

Plani i Praktikantëve për profesionin e rregulluar të mësuesit të shpërndarë në 4 Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP):


DRAP Durrës 1003 praktikantë, DRAP Fier 305 praktikantë, DRAP Lezhë 363 praktikantë, DRAP Korçë 629 praktikantë.



IV.5 Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të arsimit fillor

Më 21 maj 2021, u zhvillua në zbatim të rregullores për procedurat e organizimit dhe zhvillimit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor, provimi i nxënësve të klasave të pesta.

NR.	DRAP	NUMRI I QENDRAVE TË PROVIMIT VANAF 2021	NXËNËSVE GJITHSEJ VANAF	NXËNËS QE MOREN PJESË NË VANAF 2021	NUMRI I NXËNËSVE QË MUNGUAN
1.	DRAP DURRËS	209	14695	14321	374
2.	DRAP FIER	135	5452	5307	145
3.	DRAP KORÇË	151	6487	6334	153
4.	DRAP LEZHË	97	4504	4431	73
	TOTALI	592	31138	30393	745



IV.5 Për hapjen dhe funksionimin e shkollave qendër komunitare të reja për vitin shkollor 2021-2022.

Mbështetur në “Standardet për shkollën Qendër Komunitare Nr.1794 Prot., dt.13.03.2014 dhe kriterëve të përzgjedhjes, shkresa 1794/1, datë 31.03.2014, të gjithë ZVAP që kërkuar me shkresë zyrtare, shtimin e numrit të SHQK për vitin shkollor 2021-2022, ngritën grup pune me urdhër të drejtorit të ZVAP, për monitorimin dhe verifikimin e plotësimit të kriterëve për përzgjedhjen e SHQK, nën juridiksionin e tyre.

Në shtator 2021, listës zyrtare me 266 institucione arsimore të arsimit parauniversitar SHQK, iu shtuan edhe 195 institucione arsimore të arsimit parauniversitar. Tashmë janë rreth 461 shkolla që planifikojnë dhe zhvillojnë gjatë një viti mësimor veprimtari të ndryshme, që nxisin procesin e shndërrimit të këtyre institucioneve në qendra komunitare.

DRAP	SHQK 2014-2021	SHQK 2021-2022	TOTAL SHQK
DURRËS	68	45	113
KORÇË	75	61	136
LEZHË	66	55	121
FIER	57	34	91
DPAP	266	195	461

IV.6 Provimi i shtetit në profesionin e rregulluar të mësuesit, sesioni XVI

Në zbatim të shkresës nr. 1365 prot., të datës 03.03.2021 mbi zhvillimin e provimit të shtetit në profesionin e rregulluar të mësuesit për sesionin XVI, DPAP në bashkëpunim me DRAP dhe ZVAP morën masat për regjistrimin e kandidatëve pjesëmarrës, të cilët:


- a) kishin kryer me sukses praktikën profesionale;
- b) kishin rezultuar jo të suksesshëm në sezonet e kaluara;
- c) nuk ishin paraqitur në sezonet e mëparshme;
- d) ishin në marrëdhënie pune dhe kishin përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në edukim.

DPAP verifikoi listat e ardhura nga DRAP, për plotësimin saktë të të dhënave si dhe për plotësimin e kriterëve ligjorë për kandidatët për provimin e shtetit në profesionin e rregulluar të mësuesit. Për të dhënë provimin e shtetit në profesionin e rregulluar të mësuesit për sesionin XVI, u regjistruan 1943 kandidatë, munguan 584 kandidatë, morën pjesë 1359 kandidatë,.


Të dhëna më të detajuara si më poshtë:

DRAP	REGJISTRUAR KANDIDATË SIPAS DRAP	KANDIDATË QË MUNGUAN NË PSH 2021 SIPAS DRAP	KANDIDATË QË MORËN PJESË NE PSH 2021 SIPAS DRAP	KANDIDATË MBETËS NË PSH.2021 SIPAS DRAP	KANDIDATË QË KALUAN SIPAS DRAP
Durrës	671	170	501	232	439
Fier	316	80	236	117	199
Korçë	612	241	371	209	403
Lezhë	344	93	251	126	218

1943 KANDIDATË TË REGJISTRUAR PROVIM SHTETI 2021



REGJISTRUAR KANDIDATË SIPAS PROFILEVE



V. BASHKËPUNIME INSTITUCIONALE

Gjatë vitit 2021 DPAP-ja ka bashkëpunuar me institucionet MASR, ASCAP, DRAP dhe ZVAP duke dhënë sugjerime për:

- Rregulloren për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë.
- Strategjinë 2021-2026 MASR.

- Udhëzimin Nr.12, datë 10.06.2021, “ Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimi e portalit “ Mësues për Shqipërinë”.
- Udhëzimin Nr.2, datë 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”.
- Vlerësimin e Kartës së performancës së shkollës.
- Standardet profesionale të vlerësuesit të institucioneve të arsimit parauniversitar.
- Zbatimin e Urdhërit nr.313, datë 20.10.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social.
- Për disa ndryshime në urdhërin nr.234, datë 19.04.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar”.
- Draft rregulloren e Maturës Shtetërore dhe Provimeve Kombëtare të Arsimit Bazë.
- Amzën digjitale apo mënyrën e regjistrimit të nxënësve në klasën e parë dhe të dhjetë të arsimit bazë.
- Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.30, datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”.
- VKM nr 474, datë 30.07.2021, “Për një ndryshim në VKM 486, datë 17.06.2020 “Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar”.
- Për disa ndryshime në VKM Nr. 682, datë 29.07.2015, “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, të ndryshuar.
- Udhëzimin e përbashkët të MASR dhe MFE nr 18, datë 31.08.2021 “Për disa ndryshime në udhëzimin e përbashkët nr 18, datë 01.07.2020 “Për procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar”.
- Etj.....

Për periudhën Janar-Dhjetor 2021 Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar ka zbatuar politikën menaxheriale duke u fokusuar në nevojat e domosdoshme dhe duke u përqëndruar në përgjegjësitë funksionale të saj, të cilat konsistojnë në:

- 1. Ofrimin e një shërbimi cilësor në sistemin arsimor parauniversitar nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit.*
- 2. Organizimin e punës për menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.*
- 3. Koordinimin e administrimit të burimeve njerëzore në sistemin arsimor parauniversitar sipas legjislacionit në fuqi,...etj.*

Në periudhën në vazhdim DPAP-ja do të vazhdojë punën për zbatimin me rigorozitet të politikave të institucionit dhe realizimit të objektivave e synimeve kryesore.